



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ datë ___/___ 2024

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUdhËN JANAR-PRILL 2024 ,BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,i ndryshuar, neni 48 “ Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor”, Ligji nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” , Udhëzim nr.1 datë 24.01.2024 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024’ Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”,Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën 4-mujore,viti 2024,për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

NR. _____ DATË _____

**PËR
MIRATIMIN E PROJEKT - BUXHETIT AFATMESËM 2025-2027**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” ,Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore,Udhëzimit nr.3 datë 28.02.2024 ”Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”,VKB nr.01 datë 30.01.2024 ‘Për miratimin e të ardhurave afatmesme për Buxhetin afatmesëm 2025-2027’, VKB nr.26 datë 03.04.2024 “ Për miratimin e tavaneve buxhetore për PBA 2025-2027”,Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm për vitet 2025-2027,për Bashkinë Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financë dhe Tatim-Taksave /Sektori i Buxhet –Financës dhe administrata e bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/ VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT BASHKIAK TË VEPRIMIT PËR ENERGIJINË DHE KLIMËN TË BASHKISË PËRMET.

Këshilli Bashkiak Përmet mbledhur më dt. ___/___/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" Ligji për Eficiencën e Energjisë (Ligji nr. 124/2015 i ndryshuar me nr. 28/2021) Ligji për Performancën Energjetike të Ndërtesave (Ligji nr.116/2016), Ligji për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (Ligji nr.7/2017), Planin Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP) (miratuar në dhjetor 2021), Vendim KM (nr.852, datë 7.12.2016) për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Eficiencës së Energjisë, Vendim KM (nr.342, datë 22.05.2019) për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për auditorët e energjisë, Vendimi i Këshillit të Ministrave (nr.256, datë 27.03.2020) për metodologjinë e llogaritjes së niveleve optimale të kostos për performancën minimale energjetike të ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesës, "Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes së Rendimentit të Energjisë në Ndërtesa" miratuar me VKM nr. 1094, datë 24.12.2020, Vendimi nr. 537, datë 07.08.2020 për "Kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave", Vendimi nr. 256, datë 27.03.2020 "Për Miratimin e Metodologjisë për Llogaritjen e Niveleve Optimale të Kostos për Kërkesat Minimale të Performancës Energjetike të Ndërtesave, Njësive dhe Elementeve të Ndërtesave", Vendimi nr. 958, datë 2.12.2020 për "Miratimin e procedurave dhe kushteve për certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe modelin dhe përmbajtjen e kushteve për regjistrimin e certifikatës së performancës energjetike të ndërtesave", Vendimi nr. 934, datë 25.11.2020 për "Miratimin e kriterëve dhe procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasisë së certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesin e mbikëqyrjes së certifikatave të performancës energjetike në ndërtesa", Vendim KM (nr.537, datë 8.07.2020) për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave, Vendim KM (nr.1094, datë 24.12.2020) për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës energjetike të ndërtesave, Vendimi i Këshillit të Ministrave (nr. 580, datë 28.08.2019) për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Konsoliduar të Energjisë së Rinovueshme 2019-2020, Vendimi i Këshillit të Ministrave (nr.839, datë 5.12.2007) për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të rimbursimit të akcizës dhe krijimit të objekteve për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MË, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave (nr. 349, datë 12.06.2018) për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga energjitë diellore dhe të erës dhe procedurat e përzgjedhjes së projekteve të tyre, të ndryshuar, Ligjit nr.107/2014 datë 01/10/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, **si dhe relacionin e paraqitur nga grupi i MEMU pas diskutimeve**

VENDOSI:

1. Të miratojë **Planin Bashkiak të Veprimit për Energjinë dhe Klimën, të Bashkisë Përmet**, sipas lidhjes bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/ VENDIM

PËR PËR MIRATIMIN E “PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË BASHKINË PËRMET, 2024-2029.

Këshilli Bashkik Përmet mbledhur më dt. ___/___/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të neneve 23,33, 54 shkronja k, 55 pika 2, të Ligjit Nr.139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” si dhe Ligjit nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, Ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme” VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane” VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve" VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura " VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeteve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve" VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore" VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve" VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre" VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve" VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre" VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve" VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre" Udhëzimit nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane" **si dhe relacionin e paraqitur nga sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori i Pastrim-Gjelbërimit pas diskutimeve**

VENDOSI:

1. Të miratojë: “**Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Bashkinë Përmet, 2024-2029**”. sipas lidhjes bashkëlidhur, dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË SHQIPËRISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ .2024

P/VENDIM

Për dhënie titulli “ Mirënjohje e qytetit Përmet ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.223 datë 14.05.2024 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë.

VENDOSI

1 – T”i japë titullin “**Mirënjohje e Qytetit Përmet**”

Znj.Haxhire Skënder Dhamo

me motivacionin :

“ Për kontribut të shquar në kujdesin shëndetësor në fushën e infermierisë,për vlerat e larta për mbrojtjen e shëndetit në komunitet dhe shpirtin e paepur të sacrifices,për përkushtimin.profesionalizmin dhe humanizmin që e karakterizon.

2- Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Datë _____. _____. 2024

P/VENDIM

Per miratimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmes ekonomike, deri ne 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore “ i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 “Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 te K.M.”Per percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditësuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.97 date 18.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj”. Keshilli Bashkiak,me propozim te Kryetares se Bashkise:


VENDOSI

- 1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn Prill 2024, 9 familje me nje fond prej 26.233 leke
2. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraç Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	2.178
4	Klodjana Kristofor Peci	Divorcuar	1	2.178
5	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
6	Mimoza Skender Gjoka	Divorcuar	1	2.178
7	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	3.146
8	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
9	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	2	3.267
	SHUMA			26.233

- 3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISE
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2024

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJ
MAJ 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.139 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore "I ndryshuar me VKM nr.869 date 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM-në nr.85 datë 10.02.2021;868,29.12.2021;NR.617,date22.09.2022 I perditësuar Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor, VKB nr.97 date 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajin **MAJ 2024**, **29** familje me nje fond **71.178 leke**

2.Fondet te perballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 71.178 leke

3. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	2400
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	2700
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	3000
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	2600
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	2100
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3000
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3000
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	1800
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	3000
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	1800
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	2400
12	Vera Thanas Naqe	E ve	2	2100
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	2100